

**Drejtuar:** Z. Edi Rama  
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

Z. Ulsi Manja  
Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë

**Në vëmendje të:** Z. Tedi Malaveci  
Kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë  
të Republikës së Shqipërisë

**Paris, 24 Nëntor 2022**

I nderuar Kryeministër, Ministër i Drejtësisë dhe Kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë!

Si përfaqësues të UIHJ-së (Unioni Ndërkombëtar i Përmbauesve Gjyqësorë), një organizatë me 100 Dhoma anëtare nga mbi 90 shtete, që në terma të shteteve anëtare është një ndër bashkimet më të mëdha të profesioneve ligjore në botë, ne shqyrtojmë çdo shqetësim që ngrihet nga shtete anëtare të UIHJ-së. Prej vitesh tashmë, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë të Shqipërisë është një anëtare e nderuar e organizatës sonë.

Ne po ju shkruajmë zyrtarëve shqiptarë, në një ditë të veçantë, që përkon me 70-vjetorin e krijimit të UIHJ-së, të kësaj organizate kaq të rëndësishme që përfaqëson të gjithë përmbauesit gjyqësorë në botë, duke përfshirë edhe ata të Shqipërisë.

Ne jemi vërtet të shqetësuar për aktivitetin e përmbauesve gjyqësorë privatë në Shqipëri. Kryetari i Dhomës së Përmbauesve të Shqipërisë, z. Tedi Malaveci të cilin përfitojmë nga rasti ta falënderojmë për bashkëpunimin e shkëlqyer të shumë viteve dhe i urojmë suksese për rizgjedhjen e tij si Kryetar i Dhomës për një mandat tjetër 4-vjeçar, na përcolli një panoramë të qartë mbi gjendjen e profesionit atje.

Ne e mbështesim fuqishëm Dhomën e Përmbauesve të Shqipërisë dhe kërkojmë të njëjtin angazhim nga ana juaj.

Ne i kemi ndjekur gjithmonë nga afër zhvillimet në lidhje me profesionin e përmbauesve gjyqësorë në Shqipëri, si dhe miratimin e ligjit të ri, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2019.

Jemi të informuar se prej **më shumë se 3 viteve tashmë**, aktet nënligjore që mundësojnë ushtrimin e aktivitetit dytësor nga përmbauesit gjyqësorë privatë nuk janë miratuar ende. Është e vështirë të kuptohet kjo vonesë, megjithëse ligji i ri i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë e detyronte Ministrinë e Drejtësisë të nxirrte aktet e nevojshme për ushtrimin e këtyre veprimtarive brenda 6 muajve. Kuptojmë se kjo ka shkaktuar jo pak shqetësime që prekin drejtpërdrejtë mbarëvajtjen e aktivitetit të përmbauesve shqiptarë, veçanërisht duke mbajtur në konsideratë faktin se dy vitet e pandemisë botërore shkaktuan një problem shtesë në punën e tyre, pasi përmbauesve shqiptarë ju desh të vuanin edhe prej masave ndaluese qeveritare në fushën e ekzekutimit të detyrueshëm.

Për keqardhjen tonë të madhe, siç na informoi Dhoma, vijnë ende përpjekjet për reduktimin e **tarifave të shërbimit përmbartimor** që u vendosën në vitin 2008 nga një mision i BE-së (Euralius), u ndryshuan në qershor 2017 (me tarifatat aktuale në fuqi), të cilat ne i kemi mbështetur me ekspertët tanë dhe, që në vend se të mbështeten edhe nga politikat qeveritare, ato i janë nënshtruar në fakt një sulmi të vazhdueshëm, si në rrugë gjyqësore ashtu dhe administrative.

Ne e mbështesim fort Dhomen Kombëtare të Përmbartuesve të Shqipërisë dhe nuk duam që përmbartuesit gjyqësorë privatë shqiptarë, të vihen në pozita të pamundësisë për të ushtruar profesionin e tyre, porë kjo nga këndvështrimi financiar.

Zhvillimet sociale dhe ekonomike pas krizës së COVID-19 kanë nxitur shumë vende të kenë një qasje të ndryshme ndaj sistemeve të ekzekutimit të detyrueshëm, mbledhjes së detyrimeve dhe ndaj vetë profesionit të përmbartuesit. Për ta arritur këtë, instrumente të tilla si **aktivitetet detyruese** (si mbledhja e detyrimeve me mirëkuptim), por edhe **tarifat**, duhet të favorizohen të mbështeten nga qeveria dhe jo t'i nënshtrohen një sulmi të vazhdueshëm.

Sulmi i tyre në Shqipëri konsiderohet si sulm ndaj një prej anëtarëve të rëndësishëm të UIHJ-së.

UIHJ-ja, me mbështetjen që gëzon në nivel ndërkombëtar, dëshiron ta lëvdojë Shqipërinë dhe qeverinë e saj, për ndihmën që i jep Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve të Shqipërisë dhe nuk dëshiron të bëjë të kundërtën, sa kohë jemi në dijeni edhe për aspiratat e Shqipërisë për të hyrë së shpejti në Bashkimi Evropian përmes negociatave.

Bashkimi Evropian dhe UIHJ si një nga organizatat më të mëdha të profesionistëve ligjorë në botë, i kushton një vëmendje të veçantë shërbimeve gjyqësore dhe ka një qëndrim të qartë në lidhje me kriteret që duhet të përmbushë një shtet për të mundur plotësisht ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, sikundër respekti që çdo shtet duhet të tregojë ndaj funksionarëve që mundësojnë ofrimin e këtij shërbimi - përmbartuesve gjyqësorë.

Në këtë rast, ju lutemi të merrni masa të menjëhershme për të ndihmuar dhe respektuar Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat në Shqipëri.

Së shpejti do të jemi në Tiranë për një vizitë pune, me rastin e së cilës ju kërkojmë bashkëpunim reciprok për të ardhmen që të dyja palët duam, Shtetin e së Drejtës.

Me respekt!

**Marc Schmitz**  
**President**